

**OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"**

## RAPORTI TEKNIK

***Objekti:** "Ndërtim i Tregut të Produkteve Bujqësore, Bashkia Peqin".*

## PROJEKT - ZBATIMI

VITI 2022



## **OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN”**

### **PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK**

#### **A. Hyrje:**

Objekti qe po trajtohet ne kete projekt ndodhet ne Bashkine Peqin te Qarkut te Elbasanit, me nje popullsi prej 26,136 banores sipas censusit te 2011, qe i perket zones se Shqiperise se Mesme.

Ne kete zone mbizoteron per gjithesht nje terren fushor.

Klima eshte e bute dhe me pak lageshti ne periudhen dimerore, qe shoqerohet me temperaturoa deri ne  $-1^{\circ}\text{C}$ , ndersa temperaturoa mesatare vjetore eshte  $15\div35^{\circ}\text{C}$ .

Me porosi te Bashkise Peqin, eshte realizuar Projekti i Zbatimit per “Ndertimin e Tregut te Produkteve Bujqesore ne Peqin”, investim i cili eshte shume i nevojshem per zonen pasi ne kete menyre realizohet edhe perqendrimi ne nje ambjent te caktuar i aktiviteteve agro – kulturore ne lidhje me tregimin e fruta perimeve sipas kulturave te ndryshme qe kultivojne banoret e zones.

#### **B. Gjendja Aktuale e Objektit:**

Zona ku supozohet te ndertohej Tregu i Produkteve Bujqesore ne Peqin, aktualisht eshte nje shesh i lire ne pronesi te Investitorit, Bashkia Peqin, si dhe me disa hyrje te posaçme ne nje nga rruget kryesore te zones dhe ne afersi te lumbit Shkumbin.

Ky shesh eshte percaktuar nga vete Bashkia Peqin, e cila do ta perdore per ndertimin e tregut, i cili do ti sherbeje shume banoreve te zones per tregimin e fruta perimeve sezonale. Propozimi i vete Investitorit eshte realizimi ne kohe rekord i ketij investimi me struktura metalike, te cilat do te trajtohen me gjeresisht gjate realizimit te projektit.

Me poshte po paraqesim disa foto ne lidhje me hapesiren ku do te realizohet dhe investimi perkates.

#### **C. Foto nga Gjendja Aktuale:**

**OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"**



**OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"**



## **OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"**

### **D. ZGJIDHJA E PROJEKTIT**

#### **1. Punime Prishje dhe Germimi:**

Punimet e ndertimit te tregut do te nisin fillimi si që prishjet dhe germimet e nevojshme që duhet te behen, ku permendim kryesisht prishje te strukturave te ndryshme prejt betoni apo guri te panevojshme, per lirimin total te hapesirave te sheshit, si dhe transportimin e materialeve inerte qe do te krijohen nga prishjet.

#### **2. Punime Konstruksioni Metalik (Trare + Kolona):**

Sikunder edhe bere edhe propozimi nga ana e specialisteve te Bashkise Peqin, ndertimi i tregut do te realizohet i gjithi me struktura metalike, te cilat perveç faktit qe montohen shume lehte ne ndertim, po ashtu mund te realizohet edhe çmontimi i tyre dhe perdonimi serish per nevoja te ndryshme te institucionit ne çdo moment.

Tregu do te ndertohej i ndare ne dy struktura A dhe B, ku ndermjet tyre do te jete edhe hapesira e nevojshme per qarkullimin qofte te qytetareve, po ashtu edhe per furnizimin e here pas hershem te tregut me fruta e perime te ndryshme nga shitesit.

Ndertimi i tregut do te nise fillimi si që vendosjen e kolonave metalike, te cilat sipas llogaritjeve te bera ne aftesi mbajtese te tyre, lind nevoja e perdonimit te nje seksioni drejtkendor me permaza  $80 \times 120$  mm (shiko projektin), dhe ne total per te dy strukturat do te vendosen rreth 55 kolona te ketyre permasave.


Gjatesia e kolonave nga kuota +0.00, do te jete  $L = 3.25$  per kolonat anesore dhe  $L = 3.55$  m per kolonat qendrore ku do te mbeshtetet edhe kulmi i çatise.

Ndersa mbeshtetja e tyre ne toke do te realizohet me pllaka metalike te parapergatitura te permasave  $20 \times 25$  cm, te cilat fillimi si që inkastrohen nen toke me shufra metalike ne nje thellesi variabel  $0.5 - 0.8$  m sipas terrenit dhe me pas do te betonohen me shtresa betoni te klases C 16/20, ne menyre qe te garantohet nje siguri maksimale per qendrueshmerine e tyre.

Pasi eshte realizuar vendosja e te gjitha kolonave faza e rrades e punimeve i cakton prioritet vendosjes se trareve mbeshtetes mbi kolona, te cilat po ashtu gjate llogaritjeve perkatese rezultuan te jene te nje seksioni drejtkendor me permaza  $80 \times 120$  mm (shiko projektin).

Keto do te jene trare gjatesore mbi te cilet do te mbeshtetet kapriata metalike e çatise. Lidhja e trareve me kolonat do te realizohet me saldim ose me vida (te caktohet nga mbikqyresi gjate zbatimit te punimeve).

## OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"




### 3. Punime te Çatise:

Pas realizimit te kolonave dhe trareve fillon montimi i kapriates metalike te çatise. Kapriata metalike do te realizohet me profile metalike te permasave 40 x 80 mm (shiko projektin), dhe bashkimi i tyre gjithashtu do te realizohet me saldim ose me vida. Kulmi i kapriates ne lidhjen me fundoret e saj do te kete nje disniveli prej rreth 30 cm, ne menyre qe kur te vendoset paneli sanduich te realizohet edhe pjerresia e nevojshme per kullimin e ujerave.

Panellet sanduich jane menduar te jene te nje trashesie te pakten 3 cm, te cilat gjate montimit te tyre do te kapen me vida te posaçme mbi profilet e kapriates.


Bashkimi i paneleve per gjate gjithe kulmit me te larte qe i bie ne mesin e Strukturave do te behet me llamarine te holle e nje gjeremie rreth 30 cm, ne menyre qe te shmanget edhe demtimi i tyre nga faktore te ndryshem atmosferike.

## OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"



Krahas elementeve te lartpermendur, e nevojshme per kompletimin e çatise eshte edhe sistemimi i kullimit te ujerave, i cili eshte menduar te realizohet me ulluqe horizontale prej llamarine xingat te parapergatitur sipas detajit te paraqitur ne projekt, si dhe ulluqet vetikale te pozicionuara ne rreth 20 pika shkarkimi neper kulme dhe zona te ndryshme te çatise sipas pjerresive qe do ti jepen gjate zbatimit te projektit.

Lidhja e ulluqeve vertikale me ato horizontale do te realizohet nepermjet kasetave te shkarkimit, te cilat do te jene te materialit llamarine xingat si vete ulluqet, pasi bashkimi i tyre realizohet me thjeshte gjate ndertimeve me struktura metalike si objekti ne fiale.



## **OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN”**

### **4. Punime Lyerje per profilet Metalike:**

Pas realizimit te montimit te te gjitha profileve metalike, per traret, kolonat, kapriaten e çatise dhe profilet e montimit te ballines prej druri, do te realizohet lyerja e te gjitha profileve pa perjashtim me boje vaji (ngjyra te caktohet nga Investitori ose Mbikqyresi gjate realizimit te punimeve).

Eshte caktuar lyerja me boje vaji, e cila ne perberjen e saj ka elemente antiruxho qe sherbejne per mbrojtjen e profileve ndaj ndryshkjes dhe myshkut sikunder do jene gjate gjithe kohes nen ndikimin e faktoreve te jashtem atmosferike.

Sugjerohet qe edhe pas realizimit te investimit, te merren masa nga Investitori qe profilet te vazhdojne te lyhen me boje vaji edhe ne vazhdimesi te pakten per nje periudhe kohore nje here ne gjashte ose tete muaj.

### **5. Punime Arkitektonike:**

A. Persa i takon punimeve qe lidhen me arkitekturen e objektit te tregut, i cili do te frekuentohe vazhdimesht nga qytetare te ndryshem peqinas, fillimisht permendim ballinen prej druri e cila do te vendoset ne te gjithe gjatesine perimetrale te te dyja Strukturave te tregut A dhe B, e cila jep nje impakt viziv mjaft te kenaqshem.

Para vendosjes se ballines fillimisht do te behet vendosja e profileve metalike horizontale ne te gjitha gjatesine perimetrale dhe vertikale çdo 1 m hapesire drite.


Keto profile do te realizohen me saldim dhe do te jene te permasave 40 x 40 mm.

Nderkohe qe ballina prej druri do te jete e nje trashesie prej te pakten 2 cm.

Ajo do te jete ne vazhdimesi me profile te gjerese prej 10 cm, derisa te arrije lartesine ballore prej te pakten 70 cm, dhe po ne distance 70 cm do te kthehet poshte nen ullukun horizontal deri ne puthitjen e saj me kolonen metalike.

Per me teper mbi balline sugjerohet te vendoset edhe nje mbishkrim me emertimin: “Tregu i Produktive Bujqësore, Peqin”, i cili do te sherbeje shume edhe per identifikimin e objektit nga banoret jo vendas te cilat mund te shfaqin interes ne lidhje me aktivitete tregtare qe jane thelbi i relaizimit te ketij investimi.

Me shume detaje jepen ne vizatimet e projektit.




## **OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN”**

- B. Punimi i fundit qe lidhet me arkitekturen e objektit jane punime dekorative te pozicionuara ne qendren e tregut ku do te caktohet dhe hapesira e lire e nevojshme per ndertimin e stolave dekorative metalike qe do te sherbejne per pushimin e qytetareve gjate kohes se tyre per blerjet e ndryshmet ne kete treg te ri dhe unik te qytetit te Peqinit.
- Stolat sic e permendem do te jene metalike dhe me forma arkitektonike disi te rrumbullakta me nje ulese dhe nje mbeshtetese prej druri, ne qender te tregut. Krahas ndertimit te kater stolave do te vendosen edhe kater kolona metalike ne anesore te cilat do te sherbejne per mbajtjen e mbuleses prej xhami te bombarduar, i cili pervecse i jep ambientit nje pamje unike dhe te kenaqshme do te sherbeje edhe si strehe kundra agjenteve atmosferike si reshje shiu, debore etj.
- C. Ne kategorine e punimeve arkitektonike mund te perfshijme edhe vendosjen e portave metalike ne dy nga tre hyrjet e tregut, konkretisht ne hyrjen 1 dhe 3 (shiko planimetrine e projektit).
- Portat metalike do te jene me dy hapje me rreshqitje dhe normalisht me stil dekorativ te cilat kapin permasat rreth 4 m gjeresi dhe 2 deri 2.2 m lartesi, te cilat gjithashtu do te pajisen me nje mekanizem automatik per hapje – myllje. Lloji i portes dhe mekanizmit duhet te aprovojen nga Mbikqyrei i Punimeve dhe Investitori para vendosjes se tyre ne objekt.
- D. Ne lidhje me siperfaqen e trotuarit, mund te themi qe fillimi do te behet gërmimi i dheut për trotuarë deri në thellesine 40 cm nga toka, për një gjerësi 1.5 m; furnizim dhe vendosje në vepër të bordurës së parafabrikuar dhe me permasa 20x35 cm dhe gjatësi te ndryshueshme, me nje lartësi te futur nen dhe prej 5 cm ; shtresa me zhavorr lumi me trashesi 20 cm, te ngjeshur dhe të sheshuar mire; Shtresë betoni m-150, me trashesi 10 cm dhe me fuga teknike çdo 3 m, i formuar me shtresa te holla dhe të vibruara mire; pllaka per trotuar, te vendosura në vepër mbi nje Shtresë Llaç bastard me dozim per m<sup>2</sup>: pllaka trotuari m<sup>2</sup> 1,02, Llaç bastard m-15 m<sup>3</sup> 0,02 , çimento m-400 kg 4 dhe uje, duke perfshire ngjitet, stukimin, pastrimin si dhe çdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

### **6. Punime per Mobilimin e Tregut:**

Ne perfundim te te gjitha punimeve ndertimore te lartpermendura, para venies ne funksion te objektit per Tregtimin e produkteve bujqesore eshte e nevojshme edhe ndarja e ambjenteve ne te dy Strukturat A dhe B per shfrytezimin sa me masiv te mundshem nga ana e tregtarave te ndryshem qe do te shfrytezojne keto ambjente. Ndarja e menduar nga ana jone si projektues jepet ne vizatimet perkatese.

## OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"



Persa i takon anes teknike eshte menduar te realizohet mobilimi me tavolina te permasave kryesisht  $120 \times 150$  cm, te cilat do te ralizohen me profile metalike te permasave  $40 \times 40$  mm me saldim, si dhe do te mbulohen me derrasa pishe me trashesi  $t = 5$  cm, qofte nga lart ashtu edhe ne anesore derisa te marre formen e saj per perdonim si tavoline mbeshtetese te mallrave te ndryshme qe do te tregtohen ne keto ambiente.

Shperndarja e ketyre tavolinave eshte menduar me opsine te ndryshme ku vlen te permendim Vendshitje njeshe me kater tavolina; Vendshitje dyshe me tete tavolina; Vendshitje njeshe me shtate tavolina ne forme U -je; Vendshitje e kombinuar ne forme T -je me 12 vende etj.

Totali i vendeve (tavolinave) qe do te perdoren per shitje ne Strukturen A eshte menduar te jene rreth 63 cope, ndersa ne Strukturen B rreth 32 cope.

Gjithashtu permendim qe pozicionimi dhe numri i vendshitjeve mund te pershtatet edhe nga Investitori gjate zbatimit te punimeve.

### 7. Punime per vendosjen e Tualetit publik:

Krahas te gjithe punimeve te lartpermendura ne lidhje me sistemimin e tregut te Peqinit eshte menduar si e nevojshme dhe gjithashtu sugjeruar edhe nga Investitori, vendosja e dy tualeteve publike portable (nje per femra dhe nje per meshkuj), te cilete zhvendosen lehtesisht dhe mund te perdoren ne zona te ndryshme te pozicionuara brenda ambjentit te tregut.

## **OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN”**

Ky lloj tualeti do te kete ne brendesi te gjithe elementet e nevojshem, si psh: WC allafrenga, Lavaman porcelani, depozite shkarkimi, tuba dhe rakorderi te ndryshme etj. Edhe ne kete rast para vendosjes se tualetit duhet te merret aprovimi nga Mbikqyresi i Punimeve dhe Investitorit.

Nje shembull i ketij lloj tualeti paraqitet si me poshte:




## OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"

### 8. Punime Elektrike:

Te nevojshme per realizimin e plote te Investimit te permendur ne kete Raport jane edhe shtyllat elektrike te ndriçimit, te cilat ne total do te jene 4 dhe te pozicionuara ne qoshe te ndryshme (shiko Planimetrine) ne menyre qe te realizohet ndriçimi i te gjithe ambienteve te tregut.

Eshte vodosur te perdoren shtylla te lartesise prej  $H=7m$ , me ndriçues LED dhe te gjithe aksesoret e nevojshem, te cilet jane paraqitur ne detajin e meposhtem dhe zera e punimeve te radhitura ne preventivin perkates.

Pas realizimit te germimeve pergjate linjes perkatese elektrike, shtrimin e tubave dhe percjellesave elektrike, realizimin e pusetes se kontrollit dhe montimit e shtyllave me gjithe elementet ne vend, e gjithe zona qe do preket nga keto punime do ti kthehet serish gjendjes fillestare, dmth sheshi te sistemohet sic ishte me pllakat e trotuarit.



### 9. Punime Gjelberimi:

Ne perfundim te te gjitha punimeve ndertimore, dhe rrrethimit te zones sipas projektit, do te krijohet edhe siperfaqja e gjelberuar duke bere te mundur mbjelljen e pemeve, shkurreve, luleve te ndryshme, si dhe hedhje humusi ne vende te caktuara per rritjen e barit natyral.

## **OBJEKTI: "NDËRTIM I TREGUT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE, PEQIN"**

### **10. Punime Rrethimi:**

#### **THEMELI**

Themeli ku do te mbeshtetet rrethimi ne fjale, qe do te kete dhe rolin kryesor konstruktiv do te jetë prej materialit buto betoni si dhe ne forme drejtkendore i permbysur dhe i zhytur ne thellesi, me permasa paraprakisht: B = 40 cm dhe H = 50 cm.

Gjithashtu, themeli do te shtrihet ne te gjithe gjatesine e rrethimit qe arrin rreth L = 150 m.

#### **MURI**

Muri qe do te mbeshtetet mbi themel do te jetë i armuar, pra i materialit beton arme dhe do te kete nje forme drejtkendore me permasa paraprakisht: B = 20 cm dhe H = 20 cm.

Muri krahas funksionit konstruktiv do te kete edhe rol kryesor ne mbeshtetjen e profileve (tubave) metalike, te cilet do te jene te lartesise prej 2,2 m dhe gjithashtu do te vendosen per gjate gjithe gjatesise ne nje hapesire çdo 2 m, ne menyre qe te jetë me e thjeshte edhe realizimi i rrethimit me rrjete teli i materialit zingato.

### **11. Punime ne K.U.B:**

Duke marre shkas qe e gjithe siperfaqja e brendshme e tregut do te sistemohet me shtresat perkatese dhe me pllaka trotuari, lind nevoja edhe per sistemimin e ujerave siperfaquesore, duka zbatuar keshtu projektin e KUB – ve.

Sipas pjerresive te terrenit dhe ne pozicione te ndryshme te objektit do te caktohen disa puseta me kapak gize per kullimin e ujerave te cilat do te lidhen ndermjet tyre me tub HDPE te diametrit 315 mm, ndersa ne skajet fundore te objektit do te ndertohen pusetat e kontrollit, te cilat me pas do te shkarkojne ne pikat te posaçme me tub te diametrit 400 mm.

Kanali qe do te germohet per krijimin e linjes se KUB –ve, para shtrimit te tubit do te vendoset edhe nje nenshtrese rere e trashesise prej 10 cm, e me pas do te mbulohet me zhavorr.

Gjithashtu, edhe siperfaqja e jashtme e tregut, e cila do te sistemohet e gjitha me stabilizant, do te kete pjerresite e nevojshme ne menyre qe ujerat siperfaquesore te rrjedhin ne gjendje te lire per ne pikat e posaçme te cilat do te caktohen nga Mbikqyresi ose Investitori gjate zbatimit te punimeve.

#### **PËRGATITI:**

**"2 ED" sh.p.k**

Drejtues Teknik:

**Ing. MARK PEMAJ**

